



REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPK	Nr Prot.	03-02/3807/16
Dep.		Br Prot.	
Nr. i faq		Prot No.	
Broj stranica	02	Data	18-10-2016
Nr. pages		Datum	
		Date	
PRISHTINE			



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.10.2016, mori:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2782/16, për zyrtarin e lartë z.Ukë Kryeziu, Anëtar i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2782/16, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Ukë Kryeziu, Anëtar i Kuvendit të Komunës së Lipjanit .**

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit apo mos pajtueshmërisë në ushtrim në funksionit publik është vërejtur se zyrtari i lartë, z. Ukë Kryeziu, Anëtar i Kuvendit të Komunës së Lipjanit figuron si person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese zyrtari i lartë z. Ukë Kryeziu, ka ardhur në takim, ku nga zyrtaret e AKK-së është njoftuar me faktet dhe provat qe posedon AKK-ë lidhur me çështjen e iniciuar për konflikt të interesit.

Gjatë këtij takimi që kemi pasur me z. Kryeziu, aji është pajtuar me faktet e prezantuara dhe na ka njoftuar se në biznesin ku ai figuron si person i autorizuar do të ndërmerr të gjitha veprimet dhe do të autorizoj një person tjetër që të menaxhojë këtë biznes .

Me datën 13.10.2016 nga z. Ukë Kryeziu, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se në Biznesin me nr.70200736 dhe me emër “Ukë Kryeziu B.I” z. Kryeziu nuk figuron me si person i autorizuar i këtij biznesi.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Ukë Kryeziu, Anëtar i Kuvendit të Komunës së Lipjanit duke u larguar nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin privat dhe pasi janë krijuar rrethana të reja konsiderojmë se është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe mospajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues )

Shaip Havolli  
Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

